



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

PML.nr.386/2023

### NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët, Rasim Rasimi kryetar i kolegjit, Valdete Daka dhe Afrim Shala anëtarë, me bashkëpunëtoreshen profesionale Mirlinda Mejzini Simnica, në çështjen penale kundër të pandehurit N. S. etj, për shkak të veprës penale përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës nga neni 138 par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) lidhur me veprën penale kryerja e veprës terroriste nga neni 129 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe veprës penale lehtësimi dhe financimi në kryerjen e terrorizmit nga neni 131 par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special PS.nr.56/2022 të datës 26.06.2023 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti Special PN.1.S.nr.125/2023 të datës 10.07.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 07.08.2023, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit N. S. e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special PS.nr.56/2022 të datës 26.06.2023 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti Special PN.1.S.nr.125/2023 të datës 10.07.2023.

### A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti Special me aktvendimin PS.nr.56/2022 të datës 26.06.2023, të pandehurve A. Gj., E. S., N. S. dhe M. Bellaqa, për shkak të veprës penale përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës nga neni 138 par. 1 KPRK-së, lidhur me veprën penale kryerja e veprës terroriste nga neni 129 par. 1, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të pandehurit E. S. dhe A. Gj. për shkak të veprës penale në bashkëkryerje mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 2, lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i pandehuri A. Gj. për shkak të veprës penale moslajmërimi i përgatitjes së veprës penale nga neni 377 par.2, nënpar.2.1 e 2.4, lidhur me par.1 të KPRK-së, i pandehuri N. S. për shkak të veprës penale lehtësimi dhe financimi në kryerjen e terrorizmit nga neni 131 par.1 të KPRK-së, i pandehuri M.B. për shkak të veprës penale mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 2, lidhur me par.1 të KPRK-së, ua ka vazhduar masën e paraburgimit

në kohëzgjatje prej 2 (dy) muaj, ashtu që sipas këtij aktvendimi paraburgimi do t'i llogaritet nga data 27.06.2023 e deri me datën 27.08.2023. Të pandehurve paraburgimi ju është vazhduar konform dispozitës së nenit 184 par.1 nënpar.1.1 e 1.2 pika 1.2.1 dhe 1.2.3, të Kodit të Procedurës Penale (KPPK).

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti Special, me aktvendimin PN.1.S.nr.125/2023 të datës 10.07.2023 i ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të pandehurve dhe ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit N. S. av. Tomë V. Gashi, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës penale, të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimeve gjyqësore – nga neni 432 par.1, nënpar.1.3 të KPP-së, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë si të bazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, të pandehurit t'ia ndërpres masën e paraburgimit dhe t'i caktohet ndonjë masë tjetër alternative e paraparë me nenin 171 të KPP-së, apo t'i anulohet aktvendimet e kundërshtuara dhe lëndën ta kthejë në gjykatën e shkallës së dytë ose në gjykatën e shkallës së parë.

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës, me shkresën KMLP.III.nr.161/23 e datës 02.08.2023, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPP, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

- kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Mbrojtësi i të pandehurit në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë thekson se si gjykata e shkallës së parë ashtu edhe ajo e shkallës së dytë nuk kanë dhënë ndonjë arsye specifike për vazhdimin e paraburgimit por në vazhdimësi kanë dhënë arsyetime të përgjithësuara dhe kështu kanë vepruar në kundërshtim me vlerësimet e Gjykatës Kushtetuese, se të pandehurit i dihet identiteti, nuk ka tentuar të fshihet dhe me asnjë provë nuk është dëshmuar rreziku se i njëjti mund të ikë, se nuk ekzistojnë kushtet apo rrethanat se i njëjti do të mund të përsëritë veprën penale por dëshmojnë të kundërtën, ndërsa përfundimi apo kryerja e veprës penale të tentuar tashmë është gjë e pamundur.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, pretendimet e mësipërme janë të pabazuara ngase në këtë çështje penalo juridike aktakuza është ngritur në bazë të provave të cilat argumentojnë dyshimin e bazuar mirë se i pandehuri i ka kryer veprat penal për të cilat ngarkohet, kurse a do të argumentohen këto fakte do të vlerësohet në fazat e mëtejme të procedurës penale, me çka janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 184 par.1 nën par.1.1 të KPP-së për vazhdimin e paraburgimit.

Kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform nenit 184 par.1 nën par.1.2 pika 1.2.1 të KPP-së, ngase me lëshimin e të pandehurit në liri ekziston rreziku i fshehjes apo arratisjes me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale duke pasur parasysh

faktin se veprat penale për të cilat pandehet janë të natyrës së rëndë, dhe kjo jep arsye për të besuar se me gjetjen e tij në liri i njëjti do të mund të arratiset me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale e në këtë mënyrë do ta pamundësonte zhvillimin e rregullt të procedurës penale.

Gjithashtu kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit edhe konform nenit 184 par.1 nënpar.1.2 pika 1.2.3 të KPP-së, duke pasur parasysh peshën e veprave penale, faktin se i pandehuri së bashku me të pandehurit tjerë janë arrestuar në tentim për t'i blerë armët si dhe fakti se edhe më parë i njëjti ka qenë i dyshuar për vepra të njëjta penale, tregojnë rrezikun se i njëjti mund të përsëris veprën e njëjtë penale apo ndonjë vepër tjetër të ngjashme penale.

Andaj nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur, dhe në bazë të vlerësimit të tillë kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, të cilat si të drejta i konsideron edhe kjo gjykatë, ndërsa masat tjera alternative janë të pamjaftueshme për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurë dhe sigurimin e rrjedhës normale të procedurës penale.

Nga sa u parashtrua dhe në kuptim të nenit 437 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.386/2023 më datë 07.08.2023.

Bashkëpunëtorja Profesionale  
Mirlinda Mejzini Simnica

Kryetar i kolegjit  
Rasim Rasimi